

Telekomi i Kosovës SH. A.
Kosovo Telecom J. S. C.
Telekom Kosovo D. D.
Nr./No./Br. 01-1021/23
Data/Date/Datum 15-03/23
PRISHTINË, PRISTINA, PRISTINA



RAPORTI VJETOR 2022



www.kosovotelecom.com

Prishtinë, Mars 2023

RAPORTI VJETOR PËR AKTIVITETET E TELEKOMIT TË KOSOVËS SH.A. PËR VITIN 2022

VENDIM

Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës miratoi Raportin Vjetor të TK Sh.A. për vitin 2022 në mbledhjen me nr. 42 të mbajtur me datë: 15.03.2023



Delegoi

Burbuqe Hana

Kryeshefe Ekzekutive – Telekomit të Kosovës Sh.A.

Nënshkrimi

Data

15/03/2023



Aprovoi

Shpetim Dobra

Kryesues i Bordit të Drejtorëve – Telekomit të Kosovës Sh.A.

Nënshkrimi

Data

15/03/2023



PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	01
PROFIL I SHKURTËR PËR KOMPANINË	02
RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	03
AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES SË TK-SË	05
INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTËN	06
TË DHËNAT PËR DREJTORET JO-EKZEKUTIV	06
FJALA HYRËSE E KRYESHEFES EKZEKUTIVE	07
RAPORTI I KRYESHEFES EKZEKUTIVE	08
NGJARJET KRYESORE TË VITIT	10
PASQYRAT E TREGUT TË TELEKOMUNIKIMEVE NË KOSOVË	13
PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE DHE REZULTATET E INDIKATORËVE KYÇ TË PERFORMANCËS	15
PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET	18
PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT	24
SHPENZIMET KAPITALE DHE PROJEKTET	25
PERSPEKTIVA PËR TË ARDHMEN	27
RREZIQET E TË ARDHMES SË KORPORATËS	28
KALENDARI FINANCIAR	29

SHKURTESAT

TK	Telekomi i Kosovës
AB	Auditori i Brendshëm
ZKA	Zyra kombëtare e Auditimit
QoS	Kualiteti i shërbimeve (Quality of Services)
BTS	Base transmission station - Stacion bazë
NGN	(NextGenerationNetwork) = rrjetat e gjeneratës së re
EWSD	Electronic Worldwide Switch Digital
ITU	International Telecommunication Union (ITU) – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
ETS	Emergency Telecommunications Service
IPTV	Internet Protocol Television –Televizion përmes protokollit të internetit
POSTAPaid	Konsumatorët me faturë mujore
PREPAID	Konsumatorët me parapagim
SMS	Shërbimi i mesazheve me tekst
ARPU	Të ardhurat mesatare për konsumator
OTT	Over the Top (aplikacione për biseda, chat dhe mediatike online)
OE	Operator Ekonomik
LTE	Long Term Evolution
IP	Internet Protocol (Protokolli i Internetit)
MTI	Telekomi i Monakos, pjesa ndërkombëtare
CC377 e MCC212.	
PSO	Procedura Standarde e Operimit
2G	Gjenerata e dytë e komunikimeve mobile
3G	Gjenerata e tretë e komunikimeve mobile
4G	Gjenerata e katërt e komunikimeve mobile
GSM	Global System For Mobile Communication (Sistemi Global për Komunikim Mobil)
GPRS	GENERAL PACKET RADIO SERVICE) = Platforma për shërbimin e Internetit
EBITDA	Earning Before Interest Tax Depreciation and Amortization/ Fitimi para tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit
CAPEX	Investimet Kapitale
ISP	Internet Service Provider (Ofrues i shërbimit të internetit)
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës

I. PROFILI I SHKURTËR I KOMPANISË



Telekomi i Kosovës (TK) është kompani publike që operon sipas Legjislacionit të Republikës së Kosovës. Telekomi i Kosovës Sh.A është ofruesi më i rëndësishëm i shërbimeve dhe produkteve në fushën e komunikimeve elektronike në vend.

Synimi i përhershëm i Telekomit të Kosovës është që të jetë lider i zhvillimit të industrisë së komunikimeve elektronike në vend, duke ofruar një gamë të gjerë të produkteve të telefonisë mobile dhe fikse, dhe përmbajtje televizive me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve të vet. Qëndrueshmëria financiare është qëllimi kryesor i planifikuar për periudhën 2022-2024, që do të arrihet përmes zhvillimit të aktiviteteve, të cilat janë në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara dhe kërkesat e konsumatorëve rreth produkteve dhe shërbimeve që ofron Telekomi i Kosovës.

Si shtyllë tejet e rëndësishme dhe e përgjegjshme e komunikimeve elektronike në Kosovë, jemi të angazhuar që nga një kompani e orientuar në ofrimin e shërbimeve të zërit, të zhvillohemi më tej, në një kompani e cila ofron mundësinë e shkëmbimit të të dhënave (Internet) me një shpejtësi super të lartë, duke mundësuar kështu që konsumatorët të kenë mundësinë e shfrytëzimit të teknologjive më të reja.

Në kohën e globalizmit e të zhvillimeve tejet të hovshme teknologjike si dhe rritjen e kërkesave të konsumatorëve, Telekomi i Kosovës shfrytëzon çdo mundësi dhe të arritur që mundëson teknologjia në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve inovatore e të përshtatshme për konsumatorët e vet.

II. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE



I nderuari Aksionar,

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj raportin vjetor për Telekomin e Kosovës Sh.A që mbulon periudhën nga 1 janari 2022 deri më 31 dhjetor 2022.

Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës, i emëruar me 21.04.2021 dhe duke ushtruar funksionet në përputhje me Ligjin nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, sikurse është plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009 (referuar në vijim si "Ligji për ndërmarrjet publike"), ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e tij në përputhje me standardet më të larta profesionale të kujdesit për zhvillimin e Telekomit të Kosovës Sh.A dhe të zbatimit të detyrave fiduciare të qeverisjes korporative.

Përmes këtij raporti ju njoftoj për disa prej sfidave më të rëndësishme si dhe adresimin e tyre, për situatën financiare ende të rënduar, ballafaqimin me vështirësi të tjera, duke përfshirë paditë, kontestet dhe arbitrazhet gjyqësore (njëra prej tyre tani e fituar sipas vendimit të Arbitrazhit vendor nr. ARB 17/2018, ku TKShA ishte palë e paditur në vlerë rreth 10 Milion €), mungesën e likuiditetit dhe pamundësinë për investime në të gjitha projektet e identifikuar si të domosdoshme për rimëkëmbjen e plotë të NP TK Sh.A.

Paralelisht me këto aktivitete, për t'i adresuar sfidat dhe problemet me të cilat jemi ballafaquar, është punuar në Planin Strategjik për rimëkëmbje të plotë të Korporatës, të zbërthyer në projekte dhe plan konkret të veprimit dhe të raportuar tek Aksionari, tek i cili kemi hasur në mirëkuptim ndaj kërkesës për mbështetje financiare (në formë të kredisë së butë). Shfrytëzoj rastin që në emër të BtD të TK Sh.A dhe Menaxhmentit ekzekutiv për t'iu falënderuar Aksionarit, Ministrisë së Ekonomisë si dhe Ministrisë së Financave dhe Transfereve për mbështetjen e tyre të vazhdueshme.

Sa i përket performancës financiare për vitin 2022, ju njoftoj se NP TK ka vazhduar me përmirësimin e pasqyrave financiare, ku si rezultat i aktiviteteve të ndërmarra, trendi në rënie gjatë viteve paraprake, në vitin 2021 tregon kthim, përkatësisht trend rritës të të hyrave. Në krahasim me vitin 2021, të hyrat e TK-së në vitin 2022 paraqiten më të larta për rreth 3% (bazuar në pasqyrat financiare të paaudituar).

Në aspektin e performancës në vitin 2022, TK ka realizuar EBITDA pozitive në vlerë prej 4.4 milionë Euro. Nëse krahasohet me vitin 2021, EBITDA 2022 është më e pafavorshme për 8.2 milionë Euro në periudhën raportuese, nga 12.6 milionë Euro, sa ishte realizuar në 2021.

Fitimi/humbja para tatimit për TK-në, në vitin 2022 paraqitet me humbje prej 3.9 milionë Euro, që krahasuar me vitin 2021 është më e favorshme për 6.9 milionë Euro, në periudhën raportuese, nga -10.8 milionë Euro, sa ishte humbja në 2021, kurse në krahasim me buxhetin, humbja aktuale është më e favorshme për 1.8 milion Euro, nga -5.7 milionë Euro, sa ishte humbja e planifikuar '22.

Bordi i Drejtorëve gjatë periudhës raportuese ka vazhduar me bashkëpunim të ngushtë dhe intensiv me menaxhmentin ekzekutiv me qëllim të rimëkëmbjes së NP TK Sh.A.

Si përfundim, dëshiroj të falënderoj punonjësit, klientët dhe aksionarin tanë për mbështetjen e tyre gjatë vitit të kaluar si dhe jam i bindur se kjo mbështetje do të vazhdojë deri në rimëkëmbjen e plotë të Telekomit të Kosovës dhe përtej.

Singerisht,

Shpëtim Dobra – Kryesues i Bordit të Drejtorëve të TK Sh.A.

a. Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes së TK-së.

Gjendja financiare si dhe ajo e platformave teknologjike të Telekomit të Kosovës vazhdon të mbetet sfiduese, megjithatë Bordi i Drejtorëve ka përkrahur në vazhdimësi përpjekjet e Menaxhmentit për t'i menaxhuar të gjitha aktivitetet/veprimet e nevojshme, për t'i adresuar të gjitha sfidat ekzistuese si dhe ato të shpërfaqura gjatë vitit 2022.

Shërbimet mobile dhe fikse, që ofrohen nga infrastruktura e integruar telekomunikuese e Telekomit të Kosovës, kanë vazhduar të përmbushin kriteret e rekomanduara me standardet ndërkombëtare.

Realizimi i domosdoshëm i investimeve teknologjike dhe të mirëmbajtjes së platformave të cilat pritet të reflektojnë në rritje të të hyrave si dhe përfundimi i procesit të ristrukturimit të korporatës në funksion të modernizimit korporativ e biznesor, mbetet fokusi i Bordit dhe Menaxhmentit të TK-së edhe në këtë vit.

Nga ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes, vlen të theksohet se është nënshkruar kontrata për projektin "Migrimi në Kodin Telefonik të RKS dhe Modernizimi i rrjetit mobil", me vlerë 12.32 milionë Euro, me ç'rast Bordi i Drejtorëve ka aprovuar kredinë për huamarrje nga Aksionari/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për financimin e projekteve investive të përfshira në Planin e Biznesit të vitit 2023.

Është aprovuar procesi i Ristrukturimit të korporatës në funksion të modernizimit korporativ e biznesor dhe pritet që së shpejti të fillojë me procedurat e duhura për funksionalizim të mëtutjeshëm të skemës së re organizative.

Bordi i Drejtorëve ka aprovuar gjithashtu huamarrjen nga Qeveria për mbulimin e shpenzimeve financiare për pakot e pensionimit të parakohshëm dhe pakot dalëse, ku nga kjo pako ka përfituar një numër i konsiderueshëm i punonjësve.

Bordi i Drejtorëve të TK Sh.A e udhëzoi Menaxhmentin Ekzekutiv që të vazhdohet me procedurat për shfrytëzimin e mjeteve juridike si dhe aprovoi buxhet shtesë për avokatët ndërkombëtarë të licencuar në procedurën e anulimit të Vendimit të Arbitrazhit nr. ICC nr.24841/MHM/HHB pranë gjykatës së Londrës, si dhe gjykatave vendore. Gjithashtu BiD TK Sh.A. udhëzoi Menaxhmentin Ekzekutiv për të ushtruar kundërpadi tek Tribunali i Arbitrazhit në Zvicër për rastin nr. 300595-2022, si dhe aprovoi buxhet shtesë për angazhimin e firmës profesionale ndërkombëtare (të licencuar dhe me eksperiencë) të avokaturës për mbrojtje në rastin me paditësin Paykos pranë Qendrës Zvicerane të Arbitrazhit

Gjatë kësaj periudhe raportuese, BiD i TK Sh.A në bashkëpunim me Menaxhmentin Ekzekutiv ka iniciuar dhe aprovuar disa rregullore të brendshme të cilat do ta ndihmojnë korporatën në aspekte të ndryshme.

Si sfidë kryesore e NP TK Sh.A edhe për periudhën e vitit 2022 vazhdon të jetë gjendja e vështirësuar financiare dhe teknologjike e TK-së, megjithatë Bordi i Drejtorëve ka përkrahur fuqimisht Menaxhmentin e TK-së për të menaxhuar të gjitha aktivitetet e nevojshme dhe emergjente.

Vlen të theksoj se Telekom i Kosovës Sh.A mbetet i fokusuar në ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për klientët e tij dhe zgjerimin e mbulimit të rrjetit. Kompania do të vazhdojë të investojë në teknologji të reja, të tilla si 5G, për të qëndruar përpara konkurrencës.


b. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendën

Gjatë vitit 2022, dividendat prej TK-së për Aksionarin nuk është deklaruar. Poashtu, nuk ka pasur kërkesë nga Aksionari për tërheqje të dividendëve duke pasur parasysh situatën e performancës financiare të kompanisë gjatë periudhës raportuese dhe nevojës për investime.

Sa i përket kapitalit, TK-ja e përmbylli vitin 2022 me detyrime të konsiderueshme financiare. Mirëpo, duke pasur parasysh nevojën imediate për investime teknologjike, gjatë këtij viti janë zhvilluar aktivitete për të kërkuar përkrahje të financimit potencial, prej të cilave disa kanë rezultuar edhe me nënshkrimin e marrëveshjeve për ofrimin e huamarrjeve nga Aksionari.

c. Të dhënat për drejtorët joekzekutiv

Struktura paraqet emrat e drejtorëve joekzekutiv, zyrtarin kryesor të korporatës dhe sekretarin e korporatës/ këshilltar i përgjithshëm i korporatës.



Bordi i Drejtorëve i TK Sh.A i emëruar me Vendim të Qeverisë nr. 02/08 më datë: 21.04.2021

Kompensimi i anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore (në këtë rast Telekom Kosovës Sh.A) bëhet sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.07/81, datë: 23.03.2016.

Numri i takimeve të bordit gjatë vitit dhe numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e BtD

Takimet e bordit	Numri i takimeve	Numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takime të bordit
Takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve	18	- Kryesuesi 5 Drejtorët e Bordit - Kryeshefja Ekzekutive dhe - Këshilltari i Përgjithshëm/ Sekretari i Korporatës

Komitetet e bordit, përbërja e tyre dhe numri i takimeve të mbajtura

Komiteti i Auditimit	10	- Sajmie Thaçi, Kryesuese - Mimoza Vila, Anëtare - Agim Muçaj, Anëtar - Selvet Xhigoli, UD Auditore e Brendshme - Shqip Fazliu, Këshilltar i Përgjithshëm/ Sekretar i Korporatës
----------------------	----	--

III. FJALA HYRËSE E KRYESHEFES EKZEKUTIVE TË TELEKOMIT TË KOSOVËS



Përderisa viti 2021 ishte vit i mbijetesës dhe parandalimit të kolapsit financiar, që u ndal me një ndërhyrje të shpejtë dhe të vendosur të menaxhmentit, Bordit të Drejtorëve dhe me mbështetjen e aksionarit, viti 2022 ishte vit i stabilizimit, dhe shpresojmë të jetë trasuar rruga që viti 2023 të jetë vit i ngritjes, falë punëve që u kryen në vitin e kaluar dhe falë organizimit të ri, investimeve, motivimit të stafit dhe rikthimit të besimit të publikut.

Ky vit, ishte vit i përballimit dhe menaxhimit të suksesshëm të krizës së përgjithshme dhe vit i krijimit të një stabiliteti premtues, jo vetëm financiar, premtues për një vit të ngritjes dhe hyrjes në fazën e bërjes së një biznesi të suksesshëm dhe që kënaq pritjet e konsumatorëve dhe publikut tonë. Në shumë fusha, që nuk është e lehtë të shprehen me shifra, është arritur një menaxhim më efektiv dhe një përkushtim më i madh i stafit, që ndikuan drejtpërdrejt ose indirekt edhe në performancën e përgjithshme të kompanisë.

Duhet veçuar këtu kujdesin e shtuar të menaxhmentit dhe stafit për paranë dhe pronën publike në të gjitha proceset e brendshme dhe në marrëveshjet e jashtme, duke ngritur kështu jo vetëm performancën e njësive dhe stafit por edhe motivimin dhe përkushtimin e tyre.

Konsiderojmë që viti 2023 do të jetë vit edhe më i suksesshëm, falë stafit të motivuar, organizimit më të mirë, investimeve të mëdha, produkteve të modifikuara, marrëveshjeve të reja të biznesit, komunikimit dhe promovimit që ndjek kërkesat e tregut dhe publikut dhe mbi të gjitha zbutjes apo eliminimit të dëmeve nga kontratat e dëmshme, përmes betejave ligjore të pa kompromis.

Singerisht,

Burbuqe Hana - Kryeshefe Ekzekutive e TK Sh.A

IV. RAPORTI I KRYESHEFES EKZEKUTIVE

Me përpjekje të jashtëzakonshme të stafit, menaxhmentit, Bordit të Drejtorëve dhe me mbështetjen e duhur nga aksionari për vizionin tonë të rimëkëmbjes dhe këndelljes, arritëm të përfundojmë disa punë të rëndësishme, që i kishim nisë më herët dhe të fillojmë të tjera që shpresojmë se do të përmbyllen këtë vit apo vitin tjetër.

Viti i konceptimit dhe aprovimit të procesit të ristrukturimit dhe i fillimit të implementimit të tij

Në kuadër të procesit të ristrukturimit, është aprovuar skema e re organizative si dhe janë aprovuar rregulloret, të cilat përbëjnë pakon/grupin e dokumentacionit të ristrukturimit. Duke hapur konkurse dhe lidhur kontrata të punës sipas pozitave të skemës së re organizative, gjatë vitit 2023 kompania hyn në fazën e implementimit të këtij procesi shumë të rëndësishëm të vazhdimësisë së veprimtarisë me personelin e përzgjedhur kujdesshëm në marrëdhënie pune.

Viti i stabilizimit financiar: ulje e shpenzimeve dhe ngritje e të hyrave

Si rezultat i marrjes së një varg masash për rritjen e të hyrave dhe reduktimit të të gjitha kategorive të shpenzimeve, në vitin 2022 është krijuar një stabilitet financiar i kompanisë. Realizimi i të hyrave është bërë sipas Planit të Biznesit si dhe tejkalimi i të hyrave krahasuar me vitin paraprak është rreth 3%. Shpenzimet operative janë 36% më të ulëta se sa ishin paraparë në planin e biznesit, ndërsa në krahasim me vitin paraprak, shpenzimet janë 53% më të ulëta.

Arritëm të ulim ndjeshëm shpenzimet operative dhe njëkohësisht të shlyejmë me mjetet tona obligimet ndaj ARKEP dhe ATK, dhe të ulim ndjeshëm numrin e të punësuarve.

Veçanërisht, largimi vullnetar i 302 punëtorëve me pako vullnetare ka bërë të mundur që çdo muaj të kursehen nga rreth 270k Euro, meqenëse financimi i kësaj pakoje është bërë përmes kredisë afatgjatë, mjetet e kursyera kanë mundur që të përdoren për pagesën e detyrimeve tatimore të akumuluar nga vitet tjera.

Ndonëse edhe në vitin 2022 kompania ka operuar me humbje neto në vlerë rreth 3.9 Milionë €, në këtë humbje ka ndikuar kryesisht: shpenzimi i pagave në vlerë prej 6.2 Milionë € për pakon për largim vullnetar nga puna, pastaj 1.3 Milionë € kamata dhe gjatë nga ATK për vonesa në pagesën e obligimeve nga vitet e kaluara, njohja e kamatës prej 930K në emër të Vendimit të Arbitrazhit

Viti i rifillimit të investimeve dhe rimëkëmbjes

Falë aprovimit të huasë nga qeveria për investime në teknologji, u bë i mundur nënshkrimi i kontratës për telefoninë mobile "Migrimi në Kodin Telefonik të RKS dhe Modernizimi i rrjetit mobil". Ky është projekti më i madh i nënshkruar nga Telekomit i Kosovës (me vlerë prej rreth 12.32 Milionë €), pas një kohe të gjatë të mungesës së investimeve.

Në 2022 kemi filluar gjithashtu negociatat me palë të ndryshme për ndërrimin e platformës ekzistuese për ofrimin e përmbajtjes televizive, pasi që platforma ekzistuese IPTV është e vjetruar. Platforma e re do të jetë OTT, sepse ofron mundësi edhe për shërbime të reja OTT, jo vetëm në rrjetin fiks por edhe për klientët e rrjetit mobil. Po punohet që në vitin 2023 ta kemi platformën e re OTT.

Viti i aplikacioneve të reja, modifikimit të pakove, promovimit dhe komunikimit më të mirë

Gjatë këtij viti ndodhi zhvillimi i aplikacionit SelfCare "Vala jone", i cili u lansua në fillim të vitit 2023. Ky aplikacion do të revolucionarizojë procesin e shitjes së Telekomit të Kosovës, duke përmirësuar njëkohësisht përvojën e përgjithshme të konsumatorëve, përmes lehtësimit të blerjeve të produkteve tona, informimin në kohë reale mbi gjendjen e llogarisë dhe mundësisë së blerjeve për persona tjerë.

Vjet është realizuar një hulumtim i madh i kënaqshmërisë së konsumatorëve, me kohëzgjatje tremujore, e i cili na tregon saktësisht ku kemi nevojë të përmirësohemi. Gjithashtu, në Aeroport është bërë hulumtimi me diasporën për mënyrën e zgjedhjes së tyre në mes të produkteve tona dhe konkurrencës.

Modifikimi i suksesshëm i pakove, është bërë me qëllim ruajtjen e bazës së konsumatorëve, ngritjen e të hyrave, zvogëlimin e efekteve negative të mëhershme etj.

Është dinamizuar dhe modernizuar komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm, me ndërtimin e portalit intern Valapress dhe me organizimin më të mirë dhe shfrytëzimin më të madh të mediave sociale, me një komunikim të vazhdueshëm dhe efektiv me mediat e jashtme, duke menaxhuar suksesshëm krizat mediatike me të cilat jemi përballur gjatë vitit 2022.

Viti 2022 ishte viti i kontratave të reja dhe rritjes së të hyrave

Kemi arritur marrëveshje dhe kemi nënshkruar kontrata për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese me mbi 90% të institucioneve publike. Po ashtu nga këto kontrata në formë direkte dhe indirekte përfitojnë shërbime rreth 100,000 klientë. Afati kontraktual prej 5 viteve rëndon pozitimin e Telekomit për periudhën në vijim në këtë segment ku orientimi do të jetë në mirëmbajtjen, thellimin dhe zgjerimin e këtij bashkëpunimi.

Viti i betejave dhe fitoreve ligjore

Kemi zhvilluar një luftë ligjore për të mbrojtur kompaninë nga dëmet që ja shkaktuan kontratat e dëmshme. Vlen të përmendet fitimi i betejës ligjore në Tribunalin e Përhershëm të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të RK, rasti Intercom Ventures LLC vs Telekomit i Kosovës Sh.A. Në këtë drejtim, ishte ky një vit i angazhimit edhe në procese të tjera ligjore, të filluara më herët, vit i përgatitjes për beteja të reja ligjore lidhur me kontratat e dëmshme të nënshkruara më herët me të cilat do të na duhet të përballemi edhe përgjatë vitit 2023.

Në vijim të këtij raporti, janë ofruar informata për:

a) ngjarjet kryesore të vitit

b) pasqyrën e tregut të telekomunikimeve në Kosovë

c) pasqyrën e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

d) performancën financiare

e) progresin me planin e biznesit

f) shpenzimet kapitale dhe projektet

g) perspektivën për të ardhmen

h) rreziqet e të ardhmes

i) kalendari financiar

a) Ngjarjet kryesore të vitit

- Si aktivitet me rëndësi gjatë 2022 është konsolidimi i procesit të ristrukturimit të kompanisë. Ristrukturimi i kompanisë është konsideruar i domosdoshëm sepse synon të përcaktojë një strukturë të qartë dhe funksionale organizative me fushëveprimtari të saktësuar për çdo njësi organizative, si bazë për përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e të gjitha vendeve të punës në kompani. Në kuadër të procesit të ristrukturimit është aprovuar skema e re organizative si dhe janë aprovuar rregulloret, të cilat përbëjnë pakon/grupin e dokumentacionit të ristrukturimit. Me datën 31.08.2022 është miratuar rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës e cila ka hyrë në fuqi me datën 13.09.2022. I gjithë ky proces është realizuar nga stafi i Telekomit të Kosovës pa asnjë impakt dhe shpenzim financiar dhe konsiderohet ndër proceset më gjithëpërfshirëse të ristrukturimit të kompanisë deri më tani.
- Nënshkrimi i kontratës për telefoninë mobile "Migrimi në Kodin Telefonik të RKS dhe Modernizimi i rrjetit mobil". Ky është projekti më i madh i nënshkruar nga Telekom i Kosovës pas një kohe të gjatë të mungesës së investimeve. Modernizimi i rrjetit mobil do të bëhet në hap me trendet teknologjike dhe orientimet strategjike të TK-së, si dhe në funksion të përmbushjes së kërkesave të konsumatorëve për shërbime cilësore. Ndërrimi i kodeve në sistemet përkatëse, në aspektin teknik do t'i mundësojë Telekomit të operojë i pavarur me identitetin e vet në planin ndërkombëtar, në përputhje me kërkesat e autoriteteve të Republikës së Kosovës, por edhe t'i reduktojë kostot.
- Fitorja e betejës ligjore në Tribunalin e Përhershëm të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të RK, rasti Intercom Ventures LLC vs Telekom i Kosovës Sh.A. Me Vendimin përfundimtar të pranuar nga Tribunali i Arbitrazhit, përmes të cilit Telekom i Kosovës ka shënuar një fitore të plotë, duke refuzuar në tërësi kërkesat e palës paditëse si të pabazuara, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i Padituri TK Sh.A që Paditësit IVK LLC, në emër të dëmit të përgjithshëm-fitimit të humbur t'i paguajë shumën 10,337,264.25€ dhe janë konfirmuar në tërësi veprimet e ligjshme të Telekomit.
- Aprovimi i huasë nga qeveria për investime në teknologji me vlerë prej rreth 20mil €.
- Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A me datë 07.12.2022, me vendim unanim, përzgjedhi zonjën Burbuqe Hana në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Telekomit të Kosovës.
- Arritje tjetër është modifikimi i suksesshëm i pakos Fol L, nga rreth 2,000 pako të shitura në muaj, ka arritur në mbi 90,000 pako në muaj. Me këtë modifikim është ruajtur baza e konsumatorëve dhe njëkohësisht është rritur ARPU e përgjithshme për konsumatorët mobil Prepaid. Shih grafikun:

SHITJA E PAKOS FOL L PËR VITIN 2022



- Ofrimi i SIM Diaspora i ka tejkaluar parashikimet tona, ku nga 6,000 sa kanë qenë parashikimet, janë shitur 31,528 numra. Me këtë rast kemi rritur bazën e konsumatorëve nga segmenti i konsumatorëve nga Diaspora, duke u siguruar që të njëjtit do të jenë konsumatorë të Telekomit të Kosovës për të paktën një vit kalendarik.
- Zhvillimi i aplikacionit SelfCare "Vala jone" është në finalizim e sipër (pritet të lansohet në fillim të vitit 2023). Ky aplikacion do të revolucionarizojë procesin e shitjes së Telekomit të Kosovës, duke përmirësuar njëkohësisht përvojën e përgjithshme të konsumatorëve, përmes lehtësimit të blerjeve të produkteve tona, informimin në kohë reale mbi gjendjen e llogarisë dhe mundësisë së blerjeve për persona tjerë.

- Aktivitete tjera me rëndësi

- Modifikimi i pakove Roaming për Regjion dhe Evropë, gjë e cila ka ndikuar në rritjen e numrit të blerjeve dhe të hyrave, duke minimizuar edhe efektin negativ të implementimit të pakove RLAH.
- Aktivizimi dhe ringjallja e aktiviteteve promovuese përmes Rrjeteve Sociale, ku nga 3-4 postime në muaj, gjatë këtij viti kemi pasur rreth 40 postime në muaj.
- Ribrendimet e disa pikave shitëse në regjion të Prishtinës, Prizrenit, Pejës, në Aeroport, etj., me shpenzime minimale.
- Zbatimi i politikës së kompanisë për numrat "Gold", me efekte shumë pozitive në të hyra. Është ndërprerë procesi i keqpërdorimeve të numrave Gold dhe përdorimi i numrave të tillë tashmë siguron të hyra shtesë për Telekomin e Kosovës. Vetëm në tre muajt e parë të zbatimit të kësaj politike kemi siguruar të hyra shtesë mbi 200,000 Euro. Tani kemi mesatare rreth 20,000 Euro shtesë në muaj.
- Realizimi i madh hulumtues rreth Kënaqshmërisë së Konsumatorëve, me kohëzgjatje tremujore, e i cili na tregon saktësisht ku kemi nevojë të përmirësohemi. Gjithashtu, është bërë hulumtimi me diasporën për mënyrën e zgjedhjes së tyre në mes të produkteve tona dhe konkurrencës në Aeroport.
- Përgatitja e reklamës me sukses për brend dhe e njëjta është duke u transmetuar në tri televizione nacionale (si pjesë e kompensimit të borxheve) dhe me 3,000 sekonda falas në 5 kanale të Tring, si pjesë e kontratës për furnizim me përmbajtje televizive nga Tring.
- Modifikimi i çmimit dhe përmbajtja e numrave të ri "New SIM", me çka, përveç rritjes së drejtpërdrejtë të të hyrave, presim edhe zvogëlimin e efekteve negative që ka shkaktuar çmimi dhe përmbajtja e numrave (kartelave të reja SIM) deri tani.
- Modifikimet e qëlluara të produkteve dhe promovimi i suksesshëm me kosto minimale, kanë mundësuar realizimin e plotë të të hyrave sipas Planit të Biznesit për vitin 2022, edhe pse në fakt ka qenë një plan mjaft ambicioz dhe sfidues.

Në kuadër të departamentit të shitjes është vazhduar se punuari në përmirësimin e shitjes dhe kujdesit ndaj konsumatorëve, si dhe arrijten e marrëveshjeve me rëndësi për shërbimet telekomunikuese me konsumatorë individual, biznesor dhe institucional.

Aktivitetet e Telefonisë Mobile Vala

Në vitin 2022 kemi arritur marrëveshje për shërbimet e telefonisë mobile Vala:

Totali i kontratave/instalimeve është 13,949; prej të cilave 5,198 Postpaid dhe 8,652 Prepaid CUG. 751 janë bartës të rinj me 1,854 numra mobil; 4,244 janë shtim i numrave të rinj Postpaid në kuadër të bartësve ekzistues; 7,852 janë shtim i numrave të rinj Prepaid CUG në kuadër të bartësve ekzistues

Aktivitetet e Telefonisë Fikse TiK

Në vitin 2022 kemi arritur marrëveshje për shërbimet e telefonisë fikse TiK:

TiK 2,437 bartës të rinj; 4,208 shërbime të reja në kuadër të bartësve të rinj; 3,298 shërbime të reja në kuadër të bartësve ekzistues; Totali i shërbimeve të aktivizuara është 7,506.

Instalime/Kontrata




Në vijim janë listuar disa marrëveshje/kontrata për ofrimin e Produkteve/Shërbimeve Telekomunikuese (Telefonia Mobile Vala dhe Telefonia Fikse Tik) me konsumatorë (Individual/Biznese/Institucione) si:

- Nënshkrimi i kontratave të TEB Bankës për të gjitha shërbimet e Telekomit për periudhën 2 vjeçare;
- Fondi Monetar Ndërkombëtar për shërbimet e Telefonisë Vala;
- Community Development Fund – CDF kontratë 2 vjeçare;
- ProCredit Bank VPN 100 Mbps Pro VPN;
- Unioni Financiar Prishtinë ShPK për shërbimet e Telefonisë Vala;
- Banka Kombëtare Tregtare për shërbimet e Telefonisë Vala;
- Care Internacional për shërbimet e Telefonisë Vala;
- Oda Ekonomike e Kosovës për shërbimet e Telefonisë Vala;
- Spitali Amerikan LTK5 edhe Pro On 10Mbps për shërbimet e Telefonisë Fikse;
- Sigal për shërbimet e Telefonisë Fikse;
- Raiffeissen Bank 2 x 2Mbps VPN për shërbimet e Telefonisë Fikse;
- KFOR Gjerman Int 100 për shërbimet e Telefonisë Fikse;
- FKEE Fondi i Kosovës për Eficiência të Energjisë 2x Tel NS për shërbimet e Telefonisë Fikse;
- Pri Bank LTK 2 & 0800 Bulk Sms (2numra) dhe Sms top UP për shërbimet e tel mobile dhe fikse;
- UNMIK Tel+IPTV për shërbimet e Telefonisë Fikse;
- Internacional Organization for Migration-Bondsteel 1 GB internet, për shërbimet e Telefonisë Fikse;
- Të tjera...

Të Hyrat Financiare nga Pikat e Shitjes të Telekomit të Kosovës dhe të Postës së Kosovës

Në Vitin 2022 të hyrat financiare (qarkullimi i cash-it) nga pagesat, top UP, SIM Kartelat, Mbushjet Gërvishtëse (SC), Rigjenerime dhe Validitetet Prepaid, kanë qenë:

Te hyrat Financiare ne pikat shitese



Të Hyrat Financiare (Euro me TVSh)	Të Hyrat Financiare Viti 2021	Të Hyrat Financiare Viti 2022	Rritje/Rënie Krahvim %
Pikat e Shitjes – Telekomit i Kosovës	4,749,538.45€	4,945,316.62€	+4.12%
Pikat e Shitjes – Posta e Kosovës	16,106,535.39€	16,965,126.12€	+5.33%
Total: (TK & PK)	20,856,073.84€	21,910,442.74€	+5.06%

Përfundim :

*+4.12% ngritje te të hyrat financiare nga pikat shitëse - TK në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ose +195,778.17€.

*+5.33% ngritje te të hyrat financiare nga pikat shitëse - PK në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ose +858,590.73€.

*+5.06% ngritje te të hyrat financiare në total nga Pikat shitëse - TK dhe PK në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 +1,054,368.90€.

Në kuadër të komponentës ligjore kemi ndërmarrë veprime për konsolidimin e departamentit dhe njësive përkatëse me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes ligjore në mënyrë efikase dhe të duhur. Njëherësh janë ndërmarrë edhe disa veprime ligjore, janë iniciuar padi në gjykata të rasteve të kontratave që përmbajnë problematika të zbatimit të dispozitave të caktuara. Për detaje më të hollësishme ju lutem referohuni në shtojcën iii. dhe iv. të këtij dokumenti.

Përveç aktiviteteve të rregullta operative, gjatë vitit 2022 është punuar në modifikimin, hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve interne të kompanisë, sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të aprovuara edhe nga Bordi i Drejtorëve të TK-së.

- politika e menaxhimit të performancës me dokumentet përcjellëse ka hyrë në fuqi nga maji i vitit 2022.
- rregullorja për qasjen në objekte, zyra, ambiente dhe hapësira të veçanta të Telekomit me datën 13.01.22.
- rregullorja për marrëdhënien e punës me datën: 27.06.22.

Aktivitetet në Qendrën për Trajnim dhe Zhvillim (QTZH), duke marrë parasysh kufizimet e shkaktuara nga masat e udhëzuara nga pandemia COVID-19 dhe mungesës së hapësirës punuese, respektivisht sallave të trajnimit, janë fokusuar në azhurnimin e moduleve të trajnimit, finalizimin e moduleve dhe materialeve përcjellëse të trajnimit si dhe është punuar në përgatitjet e materialeve për riakreditim/ricertifikim të moduleve të ndryshme të trajnimit. Gjatë muajit qershor 2022 ka filluar zhvendosja e QTZH-së në objektin kryesor të Telekomit të Kosovës. Gjatë korrikut dhe gushtit, Qendra për Trajnim dhe Zhvillim ka filluar me mbajtjen e trajnimeve për stafin e QTZH. Ndërsa prej periudhës shtator – dhjetor 2022 të 5 shtyllat e QTZH-së kanë filluar me trajnime të rregullta në modulet vijuese: shtylla e MP (Menaxhimi i Projekteve), ASHKKM (Produktet dhe Shërbimet e Telekomit dhe CRM, Neuromarketing), TI (CCNAV7 Introduction to Networks, QGIS, MS Word, Testime në CCNAV7), NP (Siguria dhe Shëndeti në Punë) dhe GJA (cikli i 25-të me nivelin Beginner dhe Intermediate).

Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe të 5 shtyllat e Qendrës për Trajnim dhe Zhvillim kanë ofruar gjithsejtë 907.5 dite trajnimi për 570 punonjës të Telekomit të Kosovës.

Në aspektin e aktiviteteve të departamentit të Logjistikës, fokusi vazhdon në ofrimin e shërbimeve sa më efikase dhe bashkëpunimin me të gjitha departamentet dhe stafin e Telekomit të Kosovës në përgjithësi, si në aspektin e Transportit, Sigurisë së objekteve, Sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga Zjarri, Mirëmbajtjes së objekteve, Energjetikës, Klimatizimit dhe Monitorimit Elektronik, etj.

b) pasqyrën e tregut të telekomunikimeve në Kosovë


Referuar pasqyrës së tregut të raportuar nga ARKEP (TM4-2022), del se edhe përkundër faktit që shumica e indikatorëve të komunikimeve elektronike kanë shënuar një vijimësi (krahasimi TM4-2022 me TM4-2021), përdërisa të hyrat nga shërbimet e komunikimeve elektronike mobile dhe investimet kapitale kanë shënuar rritje. Kjo rritje e të hyrave në tregun e shërbimeve të komunikimeve elektronike shpjegohet me faktin se të gjithë operatorët e shërbimeve, veçmas ata të shërbimeve komunikuese elektronike mobile, i kanë ngritur çmimet respektivisht ARPU (me 6.1%) e që ka rezultuar me të hyra më të mëdha nga këto shërbime (me 6.1%) edhe përkundër faktit që numri i përdoruesve ka mbetur pothuajse i njëjtë. Rënie më e madhe (dhe deri diku e pritur) e të hyrave është shënuar në shërbimet e telefonisë fikse 1.5% ku njëkohësisht është edhe numri i përdoruesve të këtyre shërbimeve, si në sektorin e bizneseve po ashtu edhe në sektorin rezidencial ka shënuar rënie për afro 2% respektivisht. Një rritje e lehtë e të hyrave, e që sillet rreth vlerës prej 5.6%, vërehet edhe në shërbimet e internetit dhe kjo vjen si rezultat i rritjes së çmimeve, përdërisa numri i përdoruesve të internetit në shtëpi ka mbetur pothuajse i njëjtë.

Nga raporti i lartpërmendur del se investimet në sektorin e shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë shënuar një rritje të ndjeshme (mbi 190%) krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar. Megjithatë, nuk duhet harruar se viti 2021 ka qenë vit pandemie dhe krahasimet e lartpërmendura duhet marrë në një kontekst krahasues më të gjerë.

Në vazhdim të dokumentit, gjithmonë duke iu referuar raportit në fjalë, do të analizohet pozicioni i Telekomit në të gjitha llojet e shërbimeve të komunikimeve elektronike në të cilat ai operon. Sikur u tha më lartë, të hyrat në shërbimet mobile kanë shënuar rritje të konsiderueshme e cila shpjegohet me rritje të ARPU, respektivisht rritje të çmimeve edhe përkundër faktit se numri i përdoruesve të këtyre shërbimeve ka shënuar një rritje të lehtë. Duhet shtuar se numri

i përdoruesve të shërbimeve mobile në TM4-2022, ka shënuar një rënie të konsiderueshme (rreth 8%) krahasuar me TM3-2022, e cila rënie shpjegohet me efektin sezonal (të verës!) e cila në rastin e Kosovës manifestohet me ardhje-largime masive të bashkatdhetarëve tanë dhe blerja nga ana e tyre (regjistrimi si "përdorues të rinj" !) e pakove të ndryshme të shërbimeve telekomunikuese nga operatorët përkatës. Duke marrë parasysh aspektin administrativ të vendosur nga ARKEP për raportimin e numrit të përdoruesve, efektet e kësaj vale konsumatorësh ("vale përdoruesish") do të vazhdojnë të ndjehen edhe në së paku dy tre periudhat raportuese tremujore. Me fjalë tjera, numri i përdoruesve të raportuar në ARKEP, nga operatorët e shërbimeve mobile do të jetë konsiderueshëm më i madh se sa ai që është në të vërtetë.

Duke iu referuar raportit në fjalë mbi numrin e përdoruesve të shërbimeve mobile, Telekom ka shënuar një rënie të lehtë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, por ka shënuar rritje nëse krahasimin e bëjmë me periudhën paraprake TM3-2022. Njëkohësisht, për të njëjtën periudhë raportuese, të hyrat e Telekomit nga ky lloj i shërbimeve janë pothuajse në nivelin e njëjtë në krahasim me tremujorin e vitit paraprak. Rënia e numrit të përdoruesve në Vala është para së gjithash rezultat i zbatimit më të përpiktë të politikave të ARKEP për raportimin e numrit të përdoruesve (numrat jo aktiv të cilët në masë të konsiderueshme janë duke u larguar nga sistemi me qëllim të rritjes së besueshmërisë së raporteve dhe pasqyritit sa më real të gjendjes faktike !). Sigurisht se kjo korrektësi në të raportuar, e ka "koston" e saj, për më tepër kur nuk dihet me saktësi se sa me përpikëri janë duke u zbatuar standardet e raportimit të numrit të përdoruesve në rastin e operatorëve tjerë në treg, para së gjithash IPKO-s, por se raportimi i gjendjes reale të Telekomit në gjithë spektrin e shërbimeve që ai e ofron në treg është detyrë e pakompromis. Në këtë vazhdë, sfidën më të mirë këtij raporti (të ARKEP !) ia bën raporti faktik i të hyrave dhe numrit të konsumatorëve në spektrin e shërbimeve mobile dhe fikse si dhe krahasimi me vitin paraprak, e që është si në vijim:



Pra, të dhënat faktike, të paraqitura në formë tabelore më lartë, tregojnë se edhe pse numri i gjithmbarshëm i konsumatorëve në dy portofolet e shërbimeve (fikse dhe mobile) në Telekom ka shënuar rënie, të hyrat kanë shënuar rritje në të dy kategoritë në krahasim me vitin e kaluar. Kjo para së gjithash sepse ka pas një menaxhim shumë më të përkushtuar dhe të përgjegjshëm të resurseve aktuale operative e edhe përkundër faktit të mungesës disavjeçare të investimeve. Sigurisht se mungesa disavjeçare e investimeve, gjendja e vështirë financiare si dhe opinionin negativ i krijuar për dhe rreth Telekomit, kanë pasur dhe kanë impaktin e tyre në biznesin e përgjithshëm të Telekomit, por se gjendja reale e Telekomit, nuk mund të përmbillet vetëm në këndvështrimin indikatorëve të tregut të raportuar në ARKEP, i cili raportim në masë të konsiderueshme lë shumë për të dëshiruar. Një provë tjetër direkte e pasqyritit joreal të situatës në treg, është edhe raportimi i numrit të përdoruesve të shërbimeve të telefonisë fikse dhe të hyrave nga ky shërbim, e të cilat në raportin e lartcekur shfaqin anomali të pashpjegueshme si në vijim:

Sipas raportit TM3-2022, tregu i telefonisë fikse i ndarë sipas përdoruesve, dominohet nga IPKO me më shumë se 48%, pasuar nga Telekom me 30% dhe Kujtesa me 21%, përderisa po ky treg në kuptimin e të hyrave dominohet nga Telekom me 66%, pasuar nga mts-kosova 21%, IPKO 8% dhe Kujtesa 4%. Kjo mospërputhje kaq e madhe në mes të numrit të përdoruesve dhe të hyrave, duke njohur joatraktivitetin e shërbimit të telefonisë fikse në kohën që jetojmë, vë pikëpyetje të mëdha në pasqyrimin real të gjendjes në treg dhe në sjelljen e konsumatorëve.

Tabela e operatorëve të licencuar për shërbime telekomunikuese dhe mediatike-argëtimit.

 TELEFONIA MOBILE • 2 Operatorë mobil të licencuar • 1 Operator i lejuar për zona të caktuara • 1 Operator Virtual • Dominimi i Konsumatorëve Prepaid	 TELEFONIA FIKSE • 4 Operatorë fiks janë duke operuar • Penetrimi i shërbimeve fikse/shtëpi 24.01 • Penetrimi i shërbimeve fiks/banor 3.93% • Teknologjia e telefonisë fikse TDM dhe VOIP • Teknologjia e operatorëve tjerë – vetëm VOIP
 OFRUES TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE • 4 OTT • 8 IPTV • 25 Operatorë Kabllorë	 INTERNETI • 5 Operatorë me nyje ndërkombëtare • 41 Operatorë të autorizuar • 5 Operatorë të lidhur me KOSIX

Sipas raportit të TM4 të ARKEP për vitin 2022, numri i përdoruesve mobil ka arritur në 1,783,419 apo 102.50 % shkallë të penetrimit.

Nga këta përdorues, Vala mban 48.4 % të tregut sipas përdoruesve, IPKO 50.05% dhe mts Doo 1.55%. Sipas të hyrave, VALA vazhdon të ketë afër 42.5% të të hyrave në treg.

Sa i përket biznesit të shërbimeve të telefonisë fikse, TM4 '22 e gjen Telekomini me 66.45% të të hyrave nga zëri.

Numri i përdoruesve (parapaguesve) të internetit me qasje brezgjërë fikse dhe mobile deri në TM4-2022, i raportuar nga operatorët është 1,548,183 ku Vala mban 50.92 % të tregut sipas përdoruesve.

c) pasqyrën e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

i. Shërbimet mobile

Infrastruktura e Telekomit të Kosovës lidhur me shërbimet mobile, ofron mbulueshmëri në bazë të popullsisë në nivel vendi prej rreth 99.5%, ndërsa mbulueshmëri të territorit mbi 94 % nëpërmjet tri teknologjive 2G, 3G dhe LTE. Numri i stacioneve bazë në fund të vitit 2022 është 545. Kapacitetet teknike të instaluar për konsumatorët prepaid dhe postpaid janë 1.5 milion. Infrastruktura teknologjike është GSM/GPRS/EDGE dhe platformat 3G/HSPA+ e 4G/LTE.

Rrjeti Radio është i përberë nga pajisjet e dy prodhuesve, ish Alcatel-Lucent dhe Nokia. Rrjeti, në fund të vitit 2022, operon me 545 stacione bazë aktive. 98 prej tyre operojnë në teknologjitë 2G dhe 3G, 231 në tri teknologjitë 2G, 3G dhe 4G, 8 operojnë në teknologjitë 2G dhe 4G, kurse 207 operojnë vetëm në teknologjinë 2G.

Aktualisht, shërbimet e qasjes brezgjërë me teknologjinë 4G/LTE janë duke u pritur shumë mirë nga konsumatorët tanë, shërbim i cili është shumë më konkurrues në krahasim me operatorët tjerë. Teknologjia e cila është duke u përdorur për këtë shërbim është pjesë e zhvillimeve të fundit teknologjike dhe këto shërbime po ofrohen për bizneset, institucionet e ndryshme dhe konsumatorët individual në Kosovë.

Duke pasur parasysh shpërndarjen aktuale të stacioneve bazë (BTS) në 3G dhe 4G, nevojitet shtim i numrit të BTS-ve, të mbi ngritur në 3G dhe 4G të BTS-ve aktual që operojnë vetëm në 2G, në mënyrë që të rritet përqindja e mbulueshmërisë me shërbime brezgjera mobile si dhe të rritet kualiteti i tyre.

Duke pasur parasysh shpërndarjen aktuale të stacioneve bazë në 3G dhe 4G, nevojitet shtim i numrit të BTS-ave të mbi ngritur në 3G dhe 4G të stacioneve bazë aktuale që operojnë vetëm në 2G, në mënyrë që të rritet përqindja e mbulueshmërisë me shërbime brezgjera mobile si dhe të rritet kualiteti i tyre.

Numri i konsumatorëve aktiv në fund të vitit 2022, është **900,468** duke përfshirë edhe konsumatorët roaming. Kurse më poshtë paraqiten konsumatorët aktiv rezident:

	Në data bazën e konsumatorëve (SDM), janë konfiguruar		Prepaid dhe Postpaid aktiv	
	2021	2022	2021	2022
2G	/	/	435,889	377,463
3G	764,980	885,224	281,473	230,457
4G	332,513	518,112	178,236	216,435

Trendet e lëvizjes së numrit të konsumatorëve aktiv në tri vitet e fundit, nuk tregojnë për ndonjë lëvizje të theksuar me përjashtim të periudhave kohore rreth festave kur prezenca e shtuar e bashkatdhetarëve reflekton.

Diagramet që paraqesin volumin kumulativ javor të trafikut mobil Voice dhe Data mund t'i gjeni në shtojcën II, pika a):

Interkoneksion - Zëri mobil

Të hyrat nga trafiku ndërkombëtar në ardhje në 2022, krahasuar me 2021, kanë pasur një rënie të ulët prej 8%, €3.17M nga €3.45M.

Shpenzimet për trafikun ndërkombëtar në shkuarje në 2022, krahasuar me 2021, janë rritur për 18%, €2.12M nga €1.8M.

Arsyet:

Dallimi më i madh në minuta vit pas viti vjen nga gjysma e parë e vitit 2022 dhe ndjek pothuajse të njëjtin trend nga viti paraprak. Shkaktari kryesor është rritja e ndjeshme e trafikut outbound roaming MTC. Kjo sjellje shpjegohet me aplikimin e tarifës zero për thirrjet e pranuar në roaming në Ballkan (RLAH), e aplikuar nga korriku 2021.




Figura 1 | Trafiku Outbound Roaming MT

- Të hyrat nga trafiku kombëtar në ardhje në 2022 kanë qenë €1.09M. Krahasuar me vitin paraprak, ka një rënie prej 9%
- Shpenzimet për trafikun kombëtar në shkuarje në 2022 kanë qenë €894k. Krahasuar me vitin paraprak, ka një rënie prej 8%, ngjashëm me të hyrat.

Roaming

- Zgjerimi i mbulueshmërisë me shërbimet e munguara roaming, si LTE e CAMEL - janë lansuar mbi 15 relacione te reja (marrëveshje të reja ose zgjerim shërbimesh).
- Performanca komerciale e roamingut në vitin 2022, ka vazhduar të përmirësohet pas vitit të pandemisë 2020:
 - o Të hyrat neto inbound janë rritur për 27%, €1.7M nga €1.3M.
 - o Shpenzimet neto outbound janë rritur vetëm 2%, €580k nga €570k.
 - o Si rezultat, neto pozicioni ose margjina e përgjithshme është rritur për 45%, €1.12M nga €780k.




Figura 2 | Të hyrat dhe shpenzimet roaming

ii. Shërbimet fikse

Sa i përket infrastrukturës së Telekomit të Kosovës për shërbimet fikse, shërbimet e konsumatorëve ofrohen nëpërmjet rrjetit qendror dhe qasës në gjatësi mbi 1000 km me optikë (kapacitete transportuese, rrjeta FTTH dhe FTTN), 150 pika të prezencës fikse me 350 nje të qasjes, 416 WiFi pika të qasjes dhe 2 sisteme komutuese EWSD PSTN (Dardania dhe Iliria) me 30 pika të qasjes RDLU.

Platformat teknologjike janë të bazuara në NGN, EWSD PSTN, IPTV dhe WiFi. Interkoneksioni ndërkombëtar mundësohet përmes: 2 lidhjeve me Shqipërinë, 2 lidhjeve me Maqedoninë Veriore dhe 1 lidhje përmes Serbisë.

Numri i konsumatorëve fiks me faturë jozero, në fund të vitit 2022 është: 26.294. Këta konsumatorë kanë një ose më shumë shërbime prej listës së shërbimeve që ofrohen - Zë, Internet, IPTV, VPN, ISDN, Centrex.

Strategjia e Marketingut e TK-së për vitin 2022, konsiston në ofrimin dhe promovimin e atyre shërbimeve që TK-në e pozicionojnë si Brand të orientuar ndaj vlerave të familjeve Kosovare, që në përvojën e përgjithshme të konsumatorëve përfaqëson kualitetin, sigurinë dhe inovacionin, në të gjitha pikat e kontaktit.

Në aspekt të aktiviteteve të lansimit të produkteve, promocioneve dhe aktiviteteve tjera në kuadër të marketingut, TK ka qenë aktiv duke ofruar produkte atraktive për konsumatorë.

Vlen të përmenden plotësimet e vazhdueshme të pakove të kombinuara të Zërit, Data dhe TV, me qëllim të rritjes së atraktivitetit të shërbimeve. Indikatorët e performancës për vitin 2022, janë paraqitur në tabelat e shtojcës VII.

d) performancën financiare

Përkundër vështirësive dhe gjendjes jo të mirë të trashëguar viteve të fundit, si rezultat i marrjes së një varg masash për rritjen e të hyrave (modifikimi i pakove) dhe reduktimit të të gjitha kategorive të shpenzimeve, në vitin 2022 është krijuar një stabilitet financiar i kompanisë.

Veçanërisht, largimi vullnetar i 302 punëtorëve me pako vullnetare ka bërë të mundur që çdo muaj të kursehen nga rreth 270k Euro. Meqenëse financimi i kësaj pakoje është bërë përmes kredisë afatgjatë, mjetet e kursyera kanë mundur që të përdoren për pagesën e detyrimeve tatimore të akumuluar nga vitet tjera.

Si rezultat, të gjitha obligimet tatimore të krijuara gjatë vitit 2022 janë paguar brenda afatit si dhe janë zvogëluar dukshëm obligimet tatimore të viteve të mëhershme nga 12.8 Milionë € në fund të vitit 2021, në 8.3 Milionë € në fund të vitit 2022 (përfshirë borxhin kryesor, kamatat dhe gjokat). Sipas parashikimeve gjatë vitit 2023 këto detyrime do të paguhen tërësisht.

Po ashtu gjatë vitit 2022 kompania ka arritur për herë të parë pas disa vitesh të paguajë me burimet të brendshme të gjitha faturat për tarifat e ARKEP që i takojnë vitit 2022 në vlerë mbi 2.5 Milion Euro, duke shmangur kamatat që aplikohen për vonesa në pagesë.

Pagesa e obligimeve tatimore dhe atyre ndaj ARKEP do të ndikojë pozitivisht në vitin 2023 dhe vitet tjera pasi që do të shmangen shpenzimet e gjokave dhe kamatave të cilat viteve të fundit kanë ngarkuar pasqyrën e të ardhurave.


Po ashtu gjatë vitit 2022 obligimet ndaj kreditorëve tjerë janë zvogëluar në minimum dhe aktualisht kemi vetëm obligimet e rregullta brenda afatit të pagesave sipas kontratave pothuaj për të gjithë kreditorët.

Edhe kjo ka ndikuar që shpenzimet për kamata dhe shpenzimet përmbartimore të zvogëlohen në minimum.

Ndonëse edhe në vitin 2022 kompania ka operuar me humbje neto në vlerë rreth 3.9 Milionë €, në këtë humbje ka ndikuar kryesisht: shpenzimi i pagave në vlerë prej 6.2 Milionë € për pakon për largim vullnetar nga puna, pastaj 1.3 Milion € kamata dhe gjokat nga ATK për vonesa në pagesën e obligimeve nga vitet e kaluara, njohja e kamatës prej 930K në emër të Vendimit të Arbitrazhit.

Në vijim është paraqitur përmbledhje e të hyrave, ku përfshihen kontributet në të hyra nga shërbimet mobile & fikse, rezultatet e performancës duke përfshirë EBITDA dhe fitimin /humbjen për vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 (pa përfshirë të hyrat nga qeveria).

Të hyrat totale sipas viteve në periudhën 2016 -2022




Në grafikun e paraqitur për qëllim të krahasimit, figurat e vitit 2022 janë rezultate nga Pasqyrat Financiare ende të paaudituar. Në aspekt të performancës, trendi në rënie gjatë viteve paraprake, në vitin 2021 dhe 2022 tregon kthim përkatësisht trend rritës të të hyrave. Në krahasim me vitin 2021, të hyrat e TK-së në vitin 2022 paraqiten më të larta për 4.18%.

Vlen të përmendet se operimet e shërbimeve mobile vazhdojnë të ndikohen negativisht nga përdorimi i aplikacioneve pa pagesë përmes përdorimit të internetit të cilat ndikojnë vazhdimisht në nivelin e të hyrave në Telekom.

Duhet potencuar faktin që në trendin e rritjes së të hyrave gjatë vitit 2022, për shërbimet e telefonisë mobile, në masë të madhe ka ndikuar:

- Modifikimi i pakove Prepaid,
- Monetarizimi i numrave të zgjedhur,
- Modifikimi i tarifave për pakot Roaming,
- Krijimi i SIM diasporës së veçantë si dhe monetarizimi i saj,
- Rritja e çmimit të SIM kartelës së re nga 3.00€ në 7.00€,
- Trajtimi i veçantë i konsumatorëve të veçantë nga Departamenti i Shitjes.

Sa i përket shërbimeve fikse, në rritjen simbolike të të hyrave ka ndikuar rritja e numrit të konsumatorëve në disa segmente, të cilët kanë trend rritës siç janë: shërbimet e kombinuara të IPTV-së, shërbimet SMART dhe shërbimet për BIZNESE.




Kontributi i të ardhurave në vitin 2022, në mes të shërbimeve mobile dhe shërbimeve fikse, është në proporcionin 82% me 18% në të mirë të shërbimeve mobile.

Në krahasim me vitin 2021, vërehet se struktura e këtyre shërbimeve qëndron në proporcion përafërsisht të njëjtë me atë të vitit 2022, që ishte 83% me 17%, në të mirë të shërbimeve mobile.

Në aspektin e performancës në vitin 2022, TK ka realizuar EBITDA pozitive në vlerë prej 4.4 milion Euro. Nëse krahasohet me vitin 2021, EBITDA 2022 është më e pafavorshme për 8.2 milionë Euro në periudhën raportuese, nga 12.6 milionë Euro, sa ishte realizuar në 2021. Krahasuar me buxhetin 2022, EBITDA aktuale është më e favorshme për 0.7 milion Euro nga 3.7mil. euro sa ishte planifikuar për 2022.

Rezultatet e performancës për vitin 2022



Fitimi/humbja para tatimit për TK-në, në vitin 2022 paraqitet me humbje prej 3.9 milionë Euro, që krahasuar me vitin 2021 është më e favorshme për 6.9 milionë Euro, në periudhën raportuese, nga -10.8 milionë Euro, sa ishte humbja në 2021, kurse në krahasim me buxhetin, humbja aktuale është më e favorshme për 1.8 milion Euro, nga -5.7 milionë Euro, sa ishte humbja e planifikuar për 2022.

Të hyrat

Të hyrat nga shërbimet e telefonisë mobile sipas segmenteve

	Aktuali 2022	Plani 2022	Diff. %	Aktuali 2021	Diff. %
Të Hyrat TM	43,446,398	43,001,411	1.03%	41,904,572	3.68%
Prepaid	32,988,528	31,755,005	3.88%	31,739,354	3.94%
Postpaid	4,374,862	4,531,995	-3.47%	4,363,133	0.27%
Roamingu	1,951,811	1,840,127	6.07%	1,497,780	30.31%
Inkomingu	1,834,481	2,948,720	-37.79%	2,071,849	-11.46%
Të hyrat interne(IPKO)	1,871,821	1,800,000	-3.99%	2,032,406	-7.90%
Të hyrat tjera	424,894	125,565	238.39%	200,051	112.39%

Bazuar në tabelën më lartë, të hyrat nga shërbimet e telefonisë mobile gjatë vitit 2022, janë realizuar në vlerë prej 43,446k Euro, që krahasuar me planin '21 janë për 1.03% më të larta, kurse krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar këto të hyra janë po ashtu për 3.68% më të larta. Në rritjen e të hyrave të shërbimit mobile, kanë ndikuar kryesisht rritja e të hyrave të segmenti Prepaid, si rezultat i rritjes së çmimeve të këtyre pakove, monetarizimi i numrave të zgjedhur, krijimi i SIM diasporës së veçantë si dhe monetarizimi i disa shërbimeve të cilat deri me tani ishin dhënë falas.

Të hyrat nga pakot Prepaid në 2022 tregojnë rritje për 3.88% krahasuar me planin ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka pasur një rritje prej 3.94%.

Të hyrat nga pakot Postpaid në 2022 janë realizuar për 3.47% më pak se sa plani '22 kurse janë për 0.27% më pak se sa viti i kaluar.

Të hyrat Roaming janë për 6.07% më të larta se sa plani si rezultat i modifikimit të tarifave për pakot Roaming kurse për 30.31% më të larta se sa viti i kaluar.

Të hyrat Inkoming kanë treguar rënie për vitin 2022 krahasuar me planin për 37.79%, të cilat kanë qenë të ndikuara nga përdorimi i aplikacioneve të shumta si dhe ndryshimi i tarifave.

Të hyrat tjera janë realizuar në masën prej 425k Euro që janë për 238.39% më të larta se sa plani '22 si dhe për 112.39% më të larta se sa të hyrat e realizuara në vitin paraprak.

Të hyrat nga shërbimet e Telefonisë fikse sipas segmenteve

	Aktuali 2022	Plani 2022	Diff. %	Aktuali 2021	Diff. %
Të Hyrat TF	9,411,798	10,504,951	-10.41%	8,843,737	6.42%
Zë	603,067	675,006	-10.66%	700,942	-13.91%
Internet	425,935	602,511	-29.31%	418,881	1.68%
Zë + Internet	440,722	540,000	-18.38%	534,288	-17.51%
IPTV kombinim	1,907,182	3,792,954	-49.72%	1,858,264	2.63%
Smart Shërbimet	14,810	17,599	-15.85%	12,944	14.42%
Biznese (shërbime)	1,601,190	2,002,150	-20.03%	1,679,491	-4.66%
Konvergjent	305	306	-0.31%	305	0.00%
Tjera	4,418,587	2,874,426	53.72%	3,639,073	21.42%

Bazuar në tabelën më lartë, të hyrat nga shërbimet e telefonisë fikse, gjatë vitit 2022, janë realizuar në vlerë prej 9,412k Euro, që krahasuar me planin 2022 janë për 10.41% më të ulëta, kurse krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar këto të hyra janë realizuar për 6.42% më të larta. Në rënien e të hyrave të të gjitha kategoritë të Telefonisë fikse krahasuar me planin '22, ka ndikuar trendi i përgjithshëm i zvogëlimit të të hyrave nga këto shërbime përveç të hyrave tjera të cilat tregojnë rritje prej 53.72%. Në këto të hyra tjera përfshihen: Të hyra nga operatorët tjerë-trafikun ndërkombëtar në ardhje dhe të hyrat nga telefonat fiks zyrtar.

Në tabelat në vijim janë të prezantuara pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e të ardhurave

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2022

ASETET	Shënim	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021 Rishikuar
Asetet jo-qarkulluese			
Asetet e patrupëzuara	6	11,047	11,914
Prona, impiantet dhe pajisjet	7	19,564	22,592
E drejta e shfrytëzimit të aseteve	7	8,237	8,041
Pasuritë financiare te disponueshme për shitje	8	2	2
Asetet e tatimit të shtyrë	9	1,099	1,234
Gjithsej Asetet jo-qarkulluese		39,949	43,783

Asetet qarkulluese			
Stoqet	10	2,390	2,787
Shpenzimet e parapaguara dhe të arkëtueshmet tjera		489	542
Të arkëtueshmet tregtare	12	3,869	3,515
Të arkëtueshmet e tatimit mbi te ardhurat	23	6	5
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	13	2,007	10,953
Gjithsej asetet qarkulluese		8,760	17,802
GJITHSEJ ASETET		48,710	61,584

EKUITETI DHE DETYRIMET

Ekuiteti			
Kapitali i emtuar	14	4,475	4,475
Komponentët tjera të kapitalit		55,000	55,000
Humbjet e akumuluar		(79,290)	(75,959)
Gjithsej ekuiteti		(19,815)	(16,484)

Detyrimet joqarkulluese			
Detyrimet -e drejta e shfrytëzimit të aseteve		6,473	8,041
Huatë afatgjata	15	9,658	-
Të pagueshmet tjera dhe akrualet afatgjata		6,290	7,548
Gjithsej detyrimet joqarkulluese		22,421	15,589

Detyrimet qarkulluese			
Të pagueshmet tregtare	16	4,490	15,277
Të pagueshmet tjera dhe akrualet	15.2	2,283	4,533
Tatimi i pagueshëm	15.2	8,173	11,542
Obligimet nga kontekstet gjyqësore	15.1	22,585	25,103
Huatë afatshkurtra	15	125	-
Detyrimet -e drejta e shfrytëzimit të aseteve		1,764	-
Të hyrat e shtyra	17	6,684	6,025
Gjithsej detyrimet qarkulluese		46,105	62,479
Gjithsej detyrimet		68,525	78,069

GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		48,710	61,584
--	--	---------------	---------------

Pasqyra e të Ardhurave për vitin 2022 në Telekomin e Kosovës

PA - Telekom i Kosovës	Aktuali Janar - Dhjetor 2022				
	Aktuale	Buxheti	Arritur	Viti i kaluar	Arritur
	€000	€000	%	€000	%
Të hyrat					
Shërbimet mobile	43,101	43,001	100.23%	41,905	102.86%
Shërbimet fikse	9,067	10,505	86.31%	8,844	102.52%
Donacionet nga Qeveria	690	0	0.00%	8,155	8%
Totali i të hyrave	52,858	53,506	98.79%	58,904	89.74%
KMSH					
KMSH	8,161	7,360	110.88%	7,796	104.68%
Provizionet nga shitja alternative	2,891	3,206	90.17%	3,204	90.22%
Total KMSH	11,052	10,566	104.59%	11,000	100.47%
Fitimi Bruto	41,806	42,940	97.36%	47,903	87.27%
Shpenzimet operative					
Shpenzimet e Përsoneleit	20,363	22,844	89.14%	23,559	86.43%
Shpenzimet e Stafit - Pako A&B	6,232	0	0.00%	-	0.00%
Total Shpenzimet e personelit	26,595	22,844	116.42%	23,559	112.88%
Shpenz. tjera operative					
Konsumi i deriv.të naftes	225	118	191.22%	147	153.16%
Sherbimet publike	1,368	1,478	92.56%	1,342	101.89%
Dogana,Taksa,Kontribute,Ndalesa	1,134	1,753	64.68%	2,016	56.25%
Mirëmbajtja dhe rregullimi	573	3,944	14.52%	701	81.69%
Shpenzimet e udhëtimit	0	16	0.00%	0	0.00%
Shpenzimet e mjeteve motorike	212	207	102.46%	137	154.21%
Shpenzimet e qirasë	6,820	7,130	95.65%	6,997	97.48%
Shpenzimet e zyres dhe administrates	652	509	128.12%	618	105.59%
Sponsorimet	0	73	0.00%	-	0.00%
Donacionet	0	26	0.00%	-	0.00%
Marketingu dhe promocionet	75	201	37.30%	92	81.47%
Shpenzimet e sigurimit,komisionet	0	11	0.00%	-	0.00%
Shpenzimet e trajnimit	4	10	40.09%	5	84.03%
Shpenzimet e konsultimit	171	568	30.14%	192	89.26%
Antarësit,Provizioni për sherbime Bankare	96	24	400.96%	14	667.54%
Borgjet e këqija	-558	360	-154.95%	-677	82.42%
Shpenzimet tjera operative	2	11	18.86%	150	1.36%
Shpenzimet tjera jo operative	1,072	2,014	53.25%	13,419	7.99%
Reprezentacioni	0	3	13.51%	0	760173.16%
Total shpenz.tjera operative	11,847	18,454	64.20%	25,154	47.10%
Total shpenzimet operative	38,442	41,298	93.09%	48,713	78.92%
Interesi bankar	-	-	0.00%	-	0.00%
Amortizimi	7,130	7,302	97.65%	9,842	72.44%
Total shpenz.ope.IB+Amortizimi	45,572	48,600	93.77%	58,556	77.83%
Fitimi para tatimit	(3,766)	(5,660)	66.54%	(10,653)	35.35%
Tatimi në fitim	136	-	0.00%	176	76.98%
Fitimi pas tatimit	(3,901)	(5,660)	68.93%	(10,829)	36.02%
Ebitda	4,437	3,656	121.36%	12,609	35.19%

Në vëmendje: Dallimi në mes të dhënave të prezantuara në Pasqyrën e të Ardhurave më lartë (formati i raportimit menaxherial) dhe Pasqyrës së të Ardhurave sipas formatit SNRF, për sa i përket shpenzimeve të qirasë dhe atyre të Zhvlerësimit dhe Amortizimit, ka të bëjë me faktin që në raportet menaxheriale për çështje krahasimi me planin dhe periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, këto shpenzime prezantohen sipas transaksioneve (rrjedhave reale) të ndodhura gjatë vitit ndërsa te Pasqyra e të Ardhurave të raportuara sipas SNRF-së, bëhen rregullimet në përputhje me standardin SNRF nr.16 i cili kërkon që qiratë afatgjatë të trajtohen si pasuri prandaj rrjedhimisht për çdo vit duhet të zhvlerësohen si ROU Shpenzimet e zhvlerësimit" dhe ROU Shpenzimet e Interesit.

Kosto e mallrave të shitura

Shpenzimet e Kostos së mallrave të shitura (KMSH) në vitin 2022 në total janë realizuar në vlerë prej 11,052k euro duke u tejkaluar për rreth 4.59% krahasuar me planin`22. Kjo ka të bëjë me rritjen e shpenzimeve te kategoria kosto direkte e shitjes e cila e ka tejkaluar planin për rreth 43.75%. Në kuadër të kategorisë së kostos direkte të shitjes janë tre lloje të shpenzimeve që kanë pasur tejkalim të planit si më poshtë:

- KMSH-Kartela SIMM & Gërvishtëse për 28%
- Shpenz.trafiku ndërk.dalës/linjat e huazuara për 73% dhe
- 'Shpenzimet nga operatorët EB6 - rregullim, trafiku në ardhje, është tejkaluar komplet shuma pasi që kontoja për këtë lloj shpenzimi është hapur më vonë – pas përmbylljes së procesit të planifikimit.

Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së trafikut për këto shërbime, riorientimit të trafikut dhe rritjes së numrit të Operatorëve me të cilët ka arritur marrëveshje bashkëpunimi Telekom i Kosovës gjatë vitit 2022.

Shpenzimet Operative

Kategoria e shpenzimeve Operative gjatë vitit 2022 janë realizuar në vlerë prej 11,847k Euro që krahasuar me planin`22 arrijnë masën prej 64.20%, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kjo kategori e shpenzimeve është realizuar në masën prej vetëm 47.10%.

Ndërsa disa kategori të shpenzimeve në kuadër të atyre Operative kanë pasur tejkalim krahasuar me planin`22:

- Konsumi i derivateve të naftës për 91%
- Shpenzimet e zyrës dhe administratës për 28%
- Anëtarësitë, Provizionet për shërbime Bankare 400.96%.

Te derivatet e naftës tejkalimi ka ndodhur kryesisht për arsye:

- Të ndërprerjes së energjisë elektrike dhe funksionimit të pajisjeve për kohë më të gjatë me gjeneratorë.
- Rritjes së çmimit të naftës në tregun e furnizimit me derivate dhe
- Furnizimit me një sasi më të madhe për arsye të lëvizjes së çmimeve në treg me ç' rast një sasi e caktuar mbetet (rezervë) të shpenzohet në periudhën e ardhshme.

Shpenzimet e zyrës dhe administratës, tejkalimi ka të bëjë me tejkalimin e shpenzimeve të planifikuara për telefonat fiks dhe mobil zyrtar.

Anëtarësitë dhe provizionet për shërbime bankare kanë tejkaluar planin`22 si rezultat i obligimeve për shpenzimet e interesit në emër të huasë së pranuar nga Qeveria.


e) progresin me planin e biznesit

Krahasuar me buxhetin e vitit 2022 kompania ka arritur që të jetë përafërsisht brenda parametrave sa i përket të hyrave, duke realizuar 99% të të hyrave të planifikuara, ndërsa të shpenzimeve në përgjithësi janë dukshëm më të ulëta sesa shpenzimet e planifikuara, përveç shpenzimeve të pagave që lidhen me shumën prej 6.2 Milionë € që u sqarua më lart e që lidhen me pakot e largimit vullnetar nga puna.

Sipas planit të biznesit 2022, ishte parashikuar që kompania të operojë me fitim neto rreth 700K, por përfshirja në shpenzime të shumës 6.2 Milionë € që nuk ishte e paraparë në planin e biznesit të vitit 2022 ka rezultuar me një humbje prej rreth 3.9 Milionë €.

Për vitin 2022 në kuadër të planit të biznesit janë planifikuar të hyra në vlerë prej 53.5 milionë Euro. Krahasuar me planin '22 të hyrat aktuale '22 janë realizuar në masën prej 98.8% kurse krahasuar me vitin e kaluar të hyrat aktuale 2022 janë realizuar në masën 89.74% nga 58.9 milionë sa ishin realizuar në vitin 2021.

Rezultatet e performancës për vitin 2022 & Buxheti



Në grafik është bërë krahasimi me vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe rezultati i vitit 2022 (A- arritur) si dhe buxheti për vitin 2022 (B-buxhet i planifikuar).

Të hyrat totale të realizuara në vitin 2022 janë për -10.24% më të ulëta se vitin e kaluar, ndërsa në krahasim me targetin e planifikuar tregojnë një rënie prej 1.19%. (duke marrë parasysh të hyrat nga donacionet e Qeverisë në vitin 2021 & 2022).

EBITDA e realizuar në vitin 2022 është në vlerë pozitive prej 4.4 Milionë euro dhe paraqet rezultat më të pafavorshëm për 8.2 Milionë Euro se sa EBITDA e realizuar në 2021 prej 12.6 milionë Euro, kurse krahasuar me planin, EBITDA aktuale 2022 është më e favorshme për 0.7 milion nga ajo e planifikuar prej 3.7 milionë Euro.

Fitimi/humbja para tatimit e realizuar në vitin 2022 paraqitet me humbje prej rreth 3.9 Milionë Euro, që paraqet rezultat më të favorshëm për 6.9 Milionë Euro nga -10.8 Milionë Euro sa ishte humbja në 2021 kurse krahasuar me planin, humbja për vitin 2022 është më e favorshme për 1.8 milion Euro nga -5.7 Milionë Euro sa ishte humbja e planifikuar për 2022.

f) shpenzimet kapitale dhe projektet

Gjatë vitit 2022, dinamika e implementimit të projekteve kapitale, nuk është e nivelit të dëshiruar, si pasojë e gjendjes së përgjithshme në Telekomin e Kosovës.

Telekomi i Kosovës ka vazhduar orientimin në realizimin e projekteve kapitale për zhvillimin dhe zgjerimin e infrastrukturës në drejtim të një rrjete të integruar telekomunikuese. Kjo infrastrukturë telekomunikuese ofron mundësitë për shërbime konvergjente si dhe zgjeron mundësitë teknike për një portfolio të shërbimeve që plotëson nevojat aktuale të konsumatorëve.

Aktivitetet të limituara operative kanë qenë të orientuara në riinxhinierimin e rrjetit mobil të BTS-ve për të siguruar optimizim të rrjetit të qasjes (pjesa mobile) dhe "Zgjerimi i rrjetit pasiv" & "Zgjerimet e rrjetit të qasjes – Pajisjet aktive" (pjesa fikse e infrastrukturës), si dhe në ndërlidhjen e BTS-ave me infrastrukturë optike.

Investimet kapitale, gjatë vitit 2022, janë fokusuar në intensifikimin e procedurave të nevojshme dhe krijimin e kushteve për realizimin e 3 projekteve:

1. Migrimi në kodin telefonik të RKS dhe Modernizimi i rrjetit mobil

Kanë përfunduar procedurat e prokurimit, janë nënshkruar kontratat dhe ka filluar implementimi. Me këtë projekt do të përmirësohet dukshëm kualiteti i shërbimeve telekomunikuese në pjesën mobile. 120 vende të reja do të shtohen në 4G, kurse 10 vende do të jenë edhe në 5G. Po ashtu, edhe vendet që s'do të jenë 5G, do të jenë të gatshme për ngritje në nivelin 5G.

Kontrata është nënshkruar me 19.12.2022, me vlerë 12.32 mil Euro dhe ka filluar implementimi. Janë realizuar takimet fillestare me Operatorin ekonomik, është vizituar bashkërisht infrastruktura ekzistuese, në mënyrë që të përpilohet plani dhe të ndahen përgjegjësitë për realizimin e projektit.

Në kuadër të projektit do të realizohen këto aktivitete:

- Implementimi i kodit shtetëror të Republikës së Kosovës në platformat Radio dhe Core të rrjetit mobil Vala, sipas kërkesave të ARKEP (Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare);
- Kodi CC 383 E.164 në SDM dhe adresat e të gjitha elementeve tjera të domosdoshme të rrjetit;
- Kodi MCC 221 E.212;
- Kodi SPC Q.708;
- Marrëveshjet roaming (në të dy drejtimet in-bound dhe out-bound) gjatë fazës së tranzicionit dhe pas migrimit;
- Avancimi i sistemeve për interceptim, ashtu dhe siç kërkohet nga autoritetet e Republikës së Kosovës;
- Modernizimi i rrjetit mobil, Radio, Core CS/PS, IP/MPLS, IMS;
- Modernizimi i sistemeve OCS/SMSC/SRP/VM (BSS Mobile);
- Furnizimi me Ridrejtues dhe UPS përkatës;
- Përkrahja teknike e sistemeve në operim.

2. Platforma OTT

Një prej platformave në të cilën po punohet intensivisht për definimin e zgjidhjes përfundimtare tekniko-teknologjike, është IPTV. Me këtë projekt, synohet implementimi i platformës OTT për shërbimet audiovizuale për të gjithë konsumatorët e Telekomit të Kosovës.

Në pjesën e fundit të vitit 2022, kemi filluar negociatat me operatorët ekonomik të cilët kanë aplikuar me oferta. Faza e pare e negociatave ka përfunduar, dhe për fazën e dytë të negociatave janë kualifikuar 4 operatorë ekonomik-konzorciume.

Janë organizuar takime me të gjithë operatorët, dhe tani jemi në përgatitje të versionit përfundimtar të dosjes së tenderit.

3. Projekti i Ekonomisë Digjitale për Kosovën (KODE)

Ministria e Ekonomisë në kuadër të Projektit të Ekonomisë Digjitale për Kosovën (KODE), me 13.06.2022, ka publikuar thirrjen për aplikim sipas skemës së granteve. 80% e vlerës totale të projekteve pa TVSH financohet nga Ministria e Ekonomisë ndërsa 20% e vlerës totale të projekteve pa TVSH financohet nga Telekom i Kosovës.


Telekom i Kosovës ka aplikuar për 12 LOTE. Pas shqyrtimit të aplikacioneve nga komisioni i Ministrisë së Ekonomisë, jemi shpallur fitues në 11 LOTE për lidhjen e BTS-ve me optikë ndërsa Marrëveshjet e Grantit janë nënshkruar me dt.14.09.2022, në vlerë prej: 636,831.66 € pa TVSH. Prej 11 projekteve: 3 kanë përfunduar dhe kanë kaluar në optikë, 1 projekt është në fazën e pranimi nga komisioni, 5 projekte janë në fazën e realizimit ndërsa për 2 projekte jemi në pritje të sigurimit të lejeve nga institucionet relevante. Këto projekte kompletohen, kur të liferohen dhe instalohen pajisjet aktive.

Përveç investimeve të cekura më lartë, TK është duke vazhduar edhe me investime të limituara në rrjetat e qasjes optike në territorin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që mediumi qasës mobil/fiks i konsumatorit (ndërlidhja e BTS-ave nëpërmjet infrastrukturës optike si dhe zgjerimi i FTTH GPON), të funksionalizojnë mundësitë performuese të platformës telekomunikuese. Në rastet e rrjetit të qasjes me çiftore bakri, po punohet në segmentimin e tyre.

Investimet tjera të projekteve kapitale përfshijnë avancime të platformave ekzistuese të TK-së, ku me theks të veçantë është integrimi i platformave të cilat mbështetin proceset kyçe të biznesit në TK dhe të platformave të faturimit. Ky integrim, mundëson automatizimin e proceseve të punës dhe konvergjencën e shërbimeve mobile dhe fikse.

Me PB 2021, janë miratuar investime kapitale në vlerë të përgjithshme prej 16.678 milionë Euro. Prej tyre, për infrastrukturën mobile 10.957 milionë Euro, për atë fikse 5.522 milionë Euro dhe për shërbimet mbështetëse 0.2 milionë Euro.

Planifikimi dhe realizimi i investimeve kapitale për vitin 2022, me sa vijon:



Investimet Kapitale (Capex) – gjatë periudhës Janar-Dhjetor`22, janë realizuar pagesa në vlerë prej 416k Euro.

Gjatë kësaj periudhe, janë iniciuar kërkesa në vlerë prej 12,607k Euro, në përputhje me Planin e aprovuar të Biznesit për vitin 2022. Prej tyre 2,979k Euro janë për shërbimet fikse, për pjesën e Telefonisë mobile janë iniciuar kërkesa në vlerë prej 9,628k.

g) perspektivën për të ardhmen

Të gjithë indikatorët dhe projeksionet tregojnë që përmirësimi i gjendjes financiare do të vazhdojë edhe në vitin 2023.

Kjo bazohet në trendin e rritjes së të hyrave, implementimin e projekteve investimeve në përmirësimin e shërbimeve në mesin e vitit 2023, reduktimin e shpenzimeve të pagave (efekti i plotë shihet në vitin 2023), reduktimi i shpenzimeve për kamata dhe gjopa si pasojë e zvogëlimit të borxheve ndaj ATK-së, ARKEP dhe kreditorëve tjerë, etj.

Sigurimi i financimit të projekteve apo investimeve përmes kredive afatgjatë do t'i mundësojë kompanisë që të mos ketë presion nga rreziku i likuiditetit.

Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare është qëllimi kryesor i planifikuar për periudhën 2023-2025, i cili synohet të arrihet përmes zhvillimit të aktiviteteve të cilat janë në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara dhe kërkesave të konsumatorëve rreth produkteve dhe shërbimeve që ofron Telekom i Kosovës. Shërbimet telekomunikuese të cilat i takojnë gjeneratës së re teknologjike mbesin në planin e zhvillimit dhe orientimit tonë strategjik. Gjithashtu, Menaxhmenti i Telekomit të Kosovës mbetet i përkushtuar që të realizojë objektivat e përcaktuara në planin e biznesit 2023-2025, për të cilat janë një sërë aktivitetsesh të planifikuara që duhet të ndërmerren.

Ristrukturimi do të ndikojë në funksionalizimin dhe koordinimin më të mirë të të gjitha departamenteve, e sidomos sinergjinë në mes marketingut e shitjes.

Konsolidimi i numrit të konsumatorëve, i shoqëruar me përmirësimin e Brendit përmes rritjes së kualitetit të produkteve dhe formave të ofrimit të shërbimeve (shitjeve), përmirësimin të komunikimit me konsumatorë, duke ngritur kështu përvojën e përgjithshme të tyre, pritet të reflektojë në rritjen e ARPU-së dhe rrjedhimisht në rritjen e të hyrave.

Implementimi i projekteve si aplikacioni Selfcare 'Vala jone' do të lehtësojë ndjeshëm pagesat për produktet tona dhe do të përmirësojë dukshëm përvojën e përgjithshme të konsumatorëve tanë. Shfrytëzimi i aplikacionit do të ndikojë në zvogëlimin e shpenzimeve të provizioneve për pagesa dhe rrjedhimisht rritjen e profitit.

Gjithashtu, implementimi i projektit për furnizim me OTT, do të mundësojë edhe ofrimin e pakove të kombinuara fikse, si dhe konvergjente (fikse dhe mobile). OTT do të ndikojë në eliminimin e problemeve teknike me ofrim të përmbajtjes me kualitative dhe gjithëpërfshirëse (përmbajtje sportive dhe të ndryshme). Kur kësaj t'i shtohet fakti i zgjerimit të rrjetit me fije optike, atëherë këto garantojnë një të ardhme shumë më optimiste edhe në ofrimin e shërbimeve fikse.

Duke cekur pikat e lartpërmendura, Telekom i synon t'i arrijë këto objektiva:

- Rritjen e ARPU-së e cila synohet të arrihet përmes, shtimit kuantitativ dhe kualitativ të shërbimeve dhe rritjes së çmimeve, duke përmirësuar shërbimeve ekzistuese me kombinime të reja.
- Rritja e bazës së konsumatorëve do të bëhet përmes: Shtimit kuantitativ dhe kualitativ të shërbimeve, dhe përmes pakove adekuate PrePaid dhe PostPaid.
- Përmirësimi i imazhit të Brendit (Brand Awareness) do të bëhet përmes: Kampanjave promovuese, që përveç arritjes së objektivave të caktuara, e ngritin edhe imazhin e Brendit të Kompanisë; Përmirësimin të Shërbimit të Konsumatorëve (Total Customer Experience).

Arritja e këtyre objektivave ndërlidhet ngushtë me investimet e nevojshme në platforma teknologjike dhe rrjeta telekomunikuese që rezultojnë në ngritjen e nivelit të shërbimeve, e rrjedhimisht me kënaqësinë e konsumatorëve me shërbimet tona.

h) rreziqet e të ardhmes

Menaxhimi i rrezikut paraqet njërin ndër faktorët kryesor që do të sigurojë se Telekom i Kosovës është duke u kujdesur në sigurimin e performancës pozitive e cila garanton se është në linjë të zhvillimit në interes të vetë punonjësve, konsumatorëve, aksionarit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Telekom i Kosovës aktualisht ballafaqohet me një numër të rreziqeve, të cilat kualifikohen e listohen si: financiare, teknike, ligjore, operacionale, strategjike dhe të jashtme.

Pamundësia e realizimit të investimeve strategjike në teknologji, do të paraqiste rrezik permanent, duke pasur parasysh se rrjeti i TK-së momentalisht përballet me shumë pengesa. Gjendja e platformave dhe sistemeve telekomunikuese vazhdon të jetë e rëndë, që rrjedhë nga mungesa e investimeve dhe mirëmbajtjes së platformave, përkatësisht, të arritjes së kontratës aktive për mirëmbajtjen dhe përkrahjen teknike të platformave të sistemeve telekomunikuese.

Përkundër përmirësimeve të dukshme të paraqitura më lartë, kompania ende përballet me rreziqe financiare dhe pasiguri të cilat kryesisht kanë të bëjnë me kontestet gjyqësore që lidhen me dy vendime të arbitrazhit me rastin Dardafon.

Aktualisht, obligimet kontestuese që lidhen me këto dy vendime sipas pretendimeve të Dardafon sillen rreth 20 Milionë €.

Për vendimin e parë të arbitrazhit, pretendimi i Dardafon është borxhi i mbetur rreth 5.7 Milionë €, ndërsa sipas Telekomit, obligimet lidhur me vendimin e parë të arbitrazhit jo vetëm që janë paguar tërësisht por edhe janë tejkaluar për rreth 14 Milionë €.

Ndërsa, lidhur me vendimin e arbitrazhit të dytë, pretendimi i Dardafon është rreth 14 Milionë € përfshirë edhe kamatat deri më 31/12/2022.

Të dy rastet aktualisht janë në procese gjyqësore. Për arbitrazhin e parë gjasat janë që epilogu gjyqësor të merret gjatë vitit 2023, ndërsa për arbitrazhin e dytë gjasat janë të vogla që të ketë epilog gjatë vitit 2023.

Në rast se kemi epilog negativ për Telekomin lidhur me këto dy procese gjyqësore, e vetmja mundësi për kryerjen e këtyre obligimeve është futja në marrëveshje për pagesë me këste për dy vitet e ardhshme.

Kjo përveç se mund të ketë kosto shtesë për Telekomin, do të ishte barrë tepër e rëndë për kompaninë dhe do të vështirësonte operimin për vitet sa do të zgjasë pagesa eventuale e kësteve.

Telekom do të shfrytëzojë çdo mjet ligjor për të fituar këto dy beteja ligjore pasi që përveç se janë shumë të rëndësishme për të ardhmen e kompanisë, këto shuma pretendohen nga Dardafon si rezultat i mashtrimeve dhe proceseve korruptive brenda dhe jashtë Telekomit.

Për momentin, përveç rasteve të përmendura, ekziston rreziku i inicimit të disa proceseve të reja në arbitrazhin vendor ose ndërkombëtar, sikurse janë rastet e disa kontraktorëve me të cilët ka mospajtime lidhur me zgjidhjen e disa mosmarrëveshjeve në implementimin e kontratave komerciale, dhe atë:

Kontestet gjyqësore, arbitrazhet, bllokimi i llogarive bankare të Telekomit të Kosovës për shkak të inicimit të procedurave përbarimore nga ana e operatorëve ekonomik dhe institucioneve tjera; numri tejet i madh i rasteve të padive të punonjësve të Telekomit të Kosovës, me rastin e vendimeve të mëhershme mbi riorganizimet e vendeve të punës dhe ndryshimit të gradave, raste/padi të cilat përbajnë vlera të larta monetare në dëm të Telekomit të Kosovës.

Bazuar në evidencën e lëndëve, kundër korporatës aktualisht janë duke u zhvilluar disa procese legale që kanë rëndësi të madhe, dhe një dozë të rrezikut me kosto rreth 3.1mil € nga 21 raste.

Rreziqe tjera për Telekomin e Kosovës gjatë vitit 2023, mbesin çështjet si:

- Mosinkasimi i llogarive të arkëtueshme, të rasteve të iniciuara në gjykata për propozim përbarim dhe depozitës financiare të mbetur në Bankën Kreditore të Prishtinës me rastin e falimentimit të kësaj banke;
- Rreziku i humbjes së pasurisë intelektuale të korporatës, mosha e shtyrë e stafit (mbi 50 vjeç) dhe mospërditësimi me njohuritë dhe zhvillimet e fundit të teknologjisë dhe shkencës, mbrojtja e shëndetit të të punësuarve dhe kostot mjekësore sipas obligimeve ligjore; Konkurrenca ilegale (IPTV dhe Internet).

i) kalendari financiar

Auditimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2022 nga Auditorët e Jashtëm duhet të prezantohen deri më datë: **30.06.2023**

Figurat e pasqyruara në këtë raport për vitin 2022 paraqesin rezultatet preliminare të paaudituar.

Bazuar në kalendarin e pasqyruar më lart, raporti i Auditorit të Jashtëm dhe Pasqyrat Financiare të Audituar pritet të publikohen deri më **30.06 2023**. Telekom i Kosovës është në proces të auditimit të Pasqyrave Financiare nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit për periudhën Janar-Dhjetor 2022, dhe pritet që brenda afatit ligjor të finalizohen Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit .